



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2288 / Prot
1

Tiranë, më 21 / 10 / 2020

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.266/1 prot “Njoftim për vend të lirë pune” të Drejtorisë Rajonale të Qendrës Lëvizëse të Formimit Profesional Publik për Zonën Verilindore, protokolluar pranë AKPA-s me nr.2288 prot, datë 17.09.2020, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 22.09.2020, si më poshtë:

Pozicionet e punës:

- a) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” Rajoni Mat
- b) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” Rajoni Bulqizë
- c) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Servis motori në automjetet e lehta” Rajoni Dibër
- d) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “ Kuzhinë”, Rajoni Dibër
- e) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” rajoni Dibër
- f) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Instalime dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik” rajoni Dibër
- g) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “ Kuzhinë” Rajoni Kukës
- h) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “ Parukeri” Rajoni Kukës

- i) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Punëtor për mbledhje dhe kultivim të bimëve mjekësore/frutat e malit” Rajoni Kukës
- j) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Kuzhinë” Rajoni B.Curri
- k) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Berber” Rajoni B.Curri
- l) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Parukeri” Rajoni Pukë
- m) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Punëtor për mbledhje dhe kultivim të bimëve mjekësore/frutat e malit” Rajoni Pukë
- n) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Parukeri” Rajoni F.Arrëz
- o) 1 mësimdhënës i formimit teorik- praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Qëndistari” rajoni F.Arrëz.

1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2.Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Qendrës Lëvizëse të Formimit Profesional Publik për Zonën Verilindore

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit

- a) letër motivimi për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
- c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”,
- d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;
- e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

- f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Drejtorisë Rajonale të Qendrës Lëvizëse të Formimit Profesional Publik për Zonën Verilindore, brenda datës 01.10.2020.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Elira DEMIRAJ